



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 12 tetor 2010, në orën 13:00, sala N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Ahmet Isufi, Besa Gaxheri, Fatmire Berisha, Ramadan Gashi, Riza Smaka dhe Đezair Murati.

Mungoi: Vladimir Todoroviçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Natyra Kosumi – KDI, Floriana Shala - OSBE.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri dhe Advie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni – Kaloshi, kryetar i Komisionit.

- Kryetari Hyseni, para se ta hapte mbledhjen, i përshëndeti të pranishmit, në veçanti anëtarin e ri, Riza Smakën - (AKR), në vend të anëtares, Suzana Novobërdaliu (është emëruar në një komision tjetër) dhe i dëshiroi mirëseardhje dhe punë të suksesshme.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Zbatimi i rregullave procedurale të afateve gjatë shqyrtimit të projektligjeve,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Zbatimi i rregullave procedurale të afateve gjatë shqyrtimit të projektligjeve

Lidhur me këtë pikë raportuan Kolë Berisha dhe Dezair Murati, të cilët duke u bazuar në përfundimin e mbledhjes së 14. 09. 2010 kishin përgatitur raport vlerësues lidhur me procesimin e Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të Projektligjit për Këshillin e Prokurimit të Kosovës dhe të Projektligjit për Prokurorin Shtetëror të Kosovës.

Pas debatit dhe vlerësimit të Raportit Komisioni e miratoi përfundimin si vijon:

- a) *Procesimi i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i Projektligjit për Këshillin e Prokurimit të Kosovës dhe i Projektligjit për prokurorin shtetëror të Kosovës, që nga shpërndarja e deri në dorëzimin e raportit me amendamente për lexim të dytë në seancën e Kuvendit, është bërë në pajtim me rregullat procedurale të Rregullores së Kuvendit.*
- b) *Edhe pse nuk ka analiza të mirëfillta për projektligje të tjera, që kanë përfunduar dhe të atyre që gjenden në procedurë të shqyrtimit nëpër komisione funksionale, vlerësohet se komisionet funksionale për arsye objektive e shpeshherë edhe për arsye subjektive, nuk i respektojnë dispozitat procedurale lidhur me afatet të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.*

Meqenëse në të shumtën e rasteve komisionet në përgjithësi nuk e përfundojnë shqyrtimin e projektligjeve brenda afatit të përcaktuar me rregullore, Komisioni u pajtua që t'i analizojë shkaqet e mospërmbyshjes së afatit të përcaktuar prej dy muajve dhe të propozojë zgjidhje.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe të azhuritit të punës së komisioneve gjatë shqyrtimit të projektligjeve dhe të krijimit të parakushteve për respektimin e afateve procedurale Komisioni nëpërmjet grupeve të punës do të propozojë zgjidhje, të cilat do jenë të gatshme për inkorporim kur Kuvendi do të vendosë për nismën e plotësimndryshimit të Rregullores.

4. Të ndryshme

Në vazhdim anëtarët e Komisionit i evidencuan disa çështje konkrete, të cilat do shoqërohen edhe me çështje të tjera, për të cilat do jepen edhe propozimamendamente, që do trajtohen në mbledhjet në vijim.

Diskutuesit, veç tjerash, si çështje me prioritet, me të cilat Komisioni dhe grupet e punës do t'i trajtojnë (të sqarohen, të plotësohen ose të ndryshohen) duke përmendur disa institute dhe nocione sikur janë: "fjalori parlamentar"; "emërtimi i komisioneve: "të përhershme dhe funksionale", "deputeti i pavarur", "shpërndarja e Kuvendit", "organet e pa varura", "konflikti i interesit", "mocionet esenciale", "imuniteti", "mandati i deputetit", "votimi", "iniciimi procedural", "Kryesia e Kuvendit", "kryetari" e të tjera.

Ahmet Isufi dhe Besa Gaxheri ishin të mendimit se plotësimndryshimi i Rregullores së Kuvendit do duhej të mbetej për pas zgjedhjeve të parakohshme kombëtare, të cilat janë në përgatitje e sipër.

Bazuar në propozimin e kryetarit të Komisionit anëtarët e zgjedhën grupin e punës në krye me Hydajet Hysenin dhe anëtarët: Kolë Berisha, Riza Smaka, përfaqësuesi i Shoqatës së Juristëve të Kosovës dhe përfaqësuesi i NDI-së, me detyrë që të përgatisin “fjalorin parlamentar”.

Kryetari Hyseni i njoftoi të pranishmit se nga Kryesia e Kuvendit me shkrim është kërkuar nga Komisioni t'i interpretojë nenet 57 dhe 69 të Rregullores se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është komision i përhershëm apo funksional.

Përfundim

Komisioni u pajtua që për mbledhjen e radhës të përgatitet interpretimi i dispozitave përkatëse që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione të trajtohet komision i përhershëm apo funksional.

Njësia mbështetëse e Komisionit .

Kryetari i Komisionit

Hydajet HYSENI - KALOSHI